REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve

***VENDIM***
***Nr. 65 Datë 13.09.2010***

**PËR**
**FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA OSSH SH.A PËR VITIN 2011**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, "*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*", të ndryshuar, neneve 18, 20, 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.03.2009, Vendimit nr.79, datë 26.06.2008, "Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes se tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 13.09.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e OSSH sh.a për përcaktimin e tarifës të shpërndarjes së energjisë elektrike për OSSH sh.a, për vitin 2011 dhe relacionin e grupit të punës

**Vendosi :**

1. Fillimin e proçedurave për përcaktimin e tarifës të shpërndarjes së energjisë elektrike për OSSH sh.a për vitin 2011.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSSH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Adresa:Rruga "Gjergj Fishta"10 Tirane
Tel/Fax +355 42 22 963
Tel +355 42 69 590
E-mail erealb@ere.gov.al
www.ere.gov.al

**KRYETARI I ERE-s**
**Bujar NEPRAVISHTA**

Adresa:Rruga "Gjergj Fishta"10 Tel/Fax +355 42 22 963
Tirane Tel +355 42 69 590
E-mail erealb@ere.gov.al www.ere.gov.al